



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 456 Prot

Shkodër, më 29.01.2026

V E N D I M

Nr. 37 Datë 29.01.2026

**"PËR MIRATIMIN E HAPJES SË PROCEDURËS SË POZICIONIT TË
ADMINISTRATORIT TË USH-SË"**


Bazuar në ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të larta në Republikën e Shqipërisë", neni 49 pika f, Ligji nr.8480 datë 27.05.1999 "Për funksionin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike" Bordi i Administrimit të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" me cilësinë e organit më të lartë drejtues administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative, pasi diskutoi për nevojën e riorganizimit sipas kërkesës të ligjit nr:80/2015. Në këtë linjë në kuader të detyrave që ligji ngarkon Bordin e Administrimit vëren se duhet të procedohet me hapjen e konkursit për pozicionin e punës "Administrator i USH-së" dhe caktimin e kriterëve dhe procedurave për emërimin e administratorit. Bordi i Administrimit ne mbledhjen e dates 29.01.2026

V E N D O S I:

1. Fillimin e procedurës për hapjen e konkursit për pozicionin e punës "Administrator i USH-së"
2. Miratimin e kriterëve të vlerësimit të kandidatëve në konkurimin për pozicionin "Administrator i USH-së" sipas materialit bashkëngjitur.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Bordit të Administrimit

Prof. Asoc. Dr. Adrian Leka





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Njoftohen të gjithë të interesuarit se në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi", shpallet konkursi **për 1 vend të lirë pune**, pozicioni Administrator i USH-së.

I. Kriteria të përgjithshme:

Kandidatët për pozicionin Administrator i Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", duhet të plotësojnë këto **kriteria të përgjithshme**:

1. Të jetë shtetas shqiptarë;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkuron;
4. Të mos jetë i denuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi.
5. Të mos jetë marrë ndaj tij masa disiplinore, që nuk është shuar sipas ligjit ose për të cilën nuk është provuar largimi i padrejtë me vendim gjyqësor të formës së prerë.
6. Të ketë vlerësime pozitive të përvojave të mëparshme të punës;
7. Të mos gjendet në kushtet e konfliktit të interesave që parashikon Ligji nr. 9367 datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", (i ndryshuar).
8. Të mos kenë dëmtuar publikisht imazhin e USH-së.
9. Të mos jenë larguar nga USH-ja pa miratimin e këtij fundit;

II. Kriteret specifike

Kandidatët për pozicionin Administrator i Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, duhet të plotësojnë këto **kritere specifike**:

1. Kandidati duhet të jetë diplomuar në të gjitha ciklet e shkollimit në fushat e Shkencave Juridike ose Ekonomike, në sistemin me kohë të plotë (*Bachelor*) dhe (*Master i Shkencave; Program studimi i integruar i ciklit të dytë ose program studimi 4- vjeçar*). Niveli minimal i diplomës për efekt kandidimi në këtë pozicion është “Master i Shkencave”.
(Për të diplomuarit jashtë vendit kërkohet certifikata e njohjes nga Ministria Përgjegjëse.)
2. Të ketë notë mesatare të përgjithshme të studimeve të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë, jo më të ulët se 7,5 (shtatë pikë pesë) Bachelor 7.5 dhe master i shkencave 7.5.
3. Të ketë jo më pak se 7 vite eksperiencë pune në pozicione që lidhen me fushat e ekonomisë dhe/ose të drejtësisë.
4. Të njohë një gjuhë të huaj të vendeve të BE-së, (anglisht, frengjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht), me nivel jo më të ulët se B1, (notë jo më të ulët se 7), të njohur zyrtarisht nga institucionet shtetërore.
5. Preferohet që kandidatët:
 - Të ketë aftësi të mira drejtuese, menaxhuese dhe raportuese;
 - Të ketë aftësi të mira në komunikim;
 - Të ketë eksperiencë pune të mëparshme në funksione drejtuese.

III. Dokumentacioni i kërkuar:

Kandidatët për pozicionin Administrator, duhet të dorëzojnë me postë drejtuar Rektoratit të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, dokumentacionin së bashku me një listë përmbledhëse të tij, si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për aplikim;
2. Jetë shkrimin (CV) sipas formatit standard (europass);
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Kopje e noterizuar e diplomës/diplomave dhe/ose njehsimin e tyre në MAS (për diplomat e marra jashtë vendit), bashkë me listën e notave të noterizuara (të të dy cikleve përkatëse të studimit).
5. Kopje e noterizuar e librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
6. Raport mjeko-ligjor për aftësi në punë (lëshuar brënda 3 muajve të fundit).
7. Formular vetëdeklarim sipas formës së kërkuar nga ligji nr. 138/2015;

8. Vërtetim i gjendjes gjyqësore (Dëshmi penaliteti); Vërtetim nga Gjykata dhe nga Prokuroria;
9. Vërtetim nga punëdhënësi të mëparshëm, që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
10. Dëshmi të njohjes së gjuhës së huaj të noterizuar;
11. Referenca nga punëdhënësi të mëparshëm, që provojnë vlerësimet pozitive në punë;
12. Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, apo të tjera të përmendura në jetë shkrim;

V.O. Mungesa e një prej dokumentacionit të kërkuar më sipër, sjell s'kualifikim të kandidatit.

Dokumentacioni i dorëzuar nuk do të kthehet mbrapsht, pasi bëhet pjesë e arkivës së Institucionit.

Kandidatët e interesuar, duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar me postë, drejtuar Rektoratit të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" (Adresa: Sheshi "2 Prilli", Shkodër, Shqipëri), me mbishkrimin "Aplikim për punë".

Afati i dorëzimit të dokumentacionit është 15 ditë kalendarike nga data e shpalljes në Buletinin e APP-së.

Konkursi do zhvillohet në dy faza. Faza I- Dokumentacioni dhe Faza II- Intervista me gojë.

Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurimit me dosje dhe me intervistë me gojë. Për çdo paqartësi mund të dërgohet email në adresën info@unishk.edu.al

Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësitë rreth të cilave do të zhvillohet intervista:

- Njohuritë mbi Ligjin nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në R.SH."
- Njohuritë mbi Ligjin nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë";
- Njohuri mbi ligjin nr. 9936, datë 26.06.2006 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
- VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.
- VKM nr.75, datë 12.02.2018 "Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor";

- Njohuri mbi 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Mënyra e vlerësimit:

Në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën.

Në lidhje me intervistën e punës kandidatët do të vlerësohen për njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me pozicionin e punës dhe kuadrit ligjor të publikuar në shpallje; eksperiencën e tyre të mëparshme; motivimin, aspiratat dhe pritshmërinë e tyre për karrierën.

Mënyra e vlerësimit të dosjes do të jetë 50% dhe 50% intervisten me gojë.